

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Sistem Fonie për Sallën e Këshillit Bashkiak”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Njësia qendrore e përpunimit (cpu) ose procesorë: 30211500 -6

Mikrofonë: 32341000 -5

Amplifikues: 32343000 -9

VLERA E FONDIT LIMIT: 2 538 100 (dy milion e pesëqind e tridhjetë e tetë mijë e njëqind) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Pogradec**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;
- c. Formulari i ofertës sipas Shtojcë 1

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” te ndryshuar si dhe në mbështetje të Nenit 26 ‘Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit’ dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar:

Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit ,sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar si dhe si dhe në Ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore financiare të 3 (tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit

në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 55 pika 4, germa b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e furnizimit -vendosjes së objektit të kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor:

- 1 (një) inxhinier Elektronik si dhe 2 (dy) Specialiste Informatike.

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

-diploma përkatëse.

-kontrata e punës e vlefshme

-si dhe të figurojë në Listëpagesa të paktën për muajin e fundit të deklaruar nga hapja e ofertave

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë një personel kryesor ose fuqi punetore, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit. Dëshmia e kërkuar për numrin e punonjësve të operatorit ekonomik është e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës si dhe është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë paraqitja e

listepagesave (te pakten muajin e fundit nga hapja e ofertave) me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. **Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të zberthimit të preventivit dhe të grafikut të levrimit të mallit.** Konkretisht:

Kerkesa për 1 (një) inxhinier Elektronik është vendosur duke u bazuar në zërat e preventivit. Ky inxhinier do të jetë përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e punimeve/ furnizimit të mallit objekt kontrate në përputhje me specifikimet teknike dhe standardet e kerkuara.

Kerkesa për 2 (dy) Specialiste Informatike është vendosur duke u bazuar në zërat e preventivit si dhe duke u nisur nga fakti që ky objekt prokurimi nuk është vetëm blerje e thjeshtë, por do të jetë furnizim / vendosje, në kushtet kur operatori ekonomik që do të fitojë tenderin duhet t'i vendosë vetë mallrat të cilat do të sjellë, lind nevoja për instalimin e tyre në menyren e kërkuar nga AK, sipas specifikimeve teknike të miratura dhe specialistet e informatikës janë adapte për të mbuluar këto fushë. Prezenca e tyre garanton AK për zbatimin e preventivit me sukses, si dhe kjo kërkesë përputhet me zërat e preventivit si dhe referuar volumeve të tij në baze të analizës teknike.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatat:

- Çertifikatë ISO 9001 e “Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” të vlefshme
- Çertifikatë ISO 27001 e “Sistemit Menaxherial të Sigurisë së Informacionit”

Çertifikata e mësipërme të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre, të lëshuara nga një Organ i Vlerësimit të Konformitetit, i akredituar nga Organizmi Kombëtar i Akreditimit ose Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.3 të DST-se janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndrydhur, të nenit 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostrat (kampionët) në orën dhe ditën e hapjes së ofertave pranë Bashkisë Pogradec, të mbyllura në kuti, mbi të cilat të shenohet: “MOS E HAPNI ME PERJASHTIM TE RASTEVE KUR ESHTË I PRANISHEM KOMISIONI I HAPJES DHE VLERESIMIT TE OFERTAVE DHE JO PERPARA DATES DHE ORES SE HAPJES SE OFERTAVE”. Mostrat të shoqërohen me një listë ku të shenohen produktet që ndodhen në kuti dhe të ketë jo më pak se 1 (një) kampion:
-1 (një) njësi Kontrolli për sistemin e konferencës Wireless
-1 (një) Mikrofon Konference me Wireless Kryetar
-1 (një) Mikrofon Konference me Wireless Delegat

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, në nenin 40, pika 6, germa a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zoterojnë mallin e kerkuar nga AK sipas specifikimeve teknike të miratuara.

2.3.5 Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates, operatori ekonomik duhet të paraqesë **autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori**, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi.

Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin (kontratë/autorizim) që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.6 Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Katalogje** për artikujt e procedurës, në të cilat të specifikohen produktet e kerkuara.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme të përcaktuara sipas pikës 2.3.5 dhe pikës 2.3.6 të DST-se janë në përputhje dhe proporcion me natyrën, objektin dhe volumnin e kontratës objekt prokurimi. Kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. AK, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Në këtë kontekst, referuar vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij për paraqitjen e dokumentit të cituar nuk ka kufizuar konkurrencën, pasi një kriter i tillë nuk është diskriminues për operatorët ekonomikë. Për autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet “mall” sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për tu paraqitur është i parashikuar dhe brenda kuadrit ligjor të sipërcituar. Neni 40 pika 6 germa b) e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t’u kërkojnë operatorëve

ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

2.3.7 Operatores ekonomike ofertues duhet të paraqesin mallra të certifikuara dhe që përmbushin standartet Europiane, sipas normativave CE, e vërtetuar kjo me paraqitjen e deklarates së konformitetit (e perkthyer dhe e noterizuar).

Argumentimi: Ky kriter vendoset për të garantuar që të gjitha pajisjet e ofruara në këtë procedurë janë të sigurta për përdorim, në përputhje me ligjin dhe teknikisht të pajtueshme me Direktivat e Bashkimit Europian .

Nepermjet ketij kriteri AK synon te garantoje:-Verifikimin e origjinës dhe besueshmërisë së mallit;-Parandalimin e furnizimit me pajisje jo-origjinale si dhe te siguroje qe pajisjet janë të certifikuara dhe të testuara.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Dokumentacioni teknik ku perfshihen Specifikimet Teknike dhe Preventivi jane hartuar nga njesia e prokurimit te ngritur me urdher te titullarit te AK, Bashkia Pogradec. Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha mallrave të kerkura nga AK, në përputhje me parashikimet e nenit 36, të LPP (e ndryshuar), si dhe Nenit 40 të VKM-se Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(e ndryshuar).

Në çdo rast nëse janë përmendur marka prodhimi , burim specifik apo proces i veçantë do të pranohen edhe ekuivalenti i tij/saj.

Gjate hartimit te specifikimeve teknike jane marre ne konsiderate kerkesat ligjore te fushes se teknologjise se informacionit si dhe normat perkatese të përcaktuara në aktet ligjore në fuqi.

NJESIA E PROKURIMIT: